



## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

### SESIONI I

(I DETYRUAR)

### SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

**VARIANTI A**

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**

**Shkolla e mesme teknike profesionale (3+2) dhe 5 vjeçare**

***Udhëzime të përgjithshme:***

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e saj, komisioni i vlerësimit këshillohet me drejtuesin teknik dhe specialistin e AVA për vlerësimin përfundimtar të pyetjes.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

**PJESA I****NAIM FRASHËRI****Bukuria**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	A	1 pikë
Pyetja 4	B	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	C	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

**Pyetja 8** **2 pikë****Model përgjigjeje:**

- Përsëritja e brendshme përfton ndjesinë: **e dhimbjes, e lutjes, e përuljes, e lektisjes, e mundimit, e ekzaltimit** etj.

**Ose**

- **Kjo përgjigje** mund të jepet në **mënyrë përshkruese**: Gjendja shpirtërore është ajo e vuajtjes, që shoqëron dashurinë. Poeti nuk e përballon dot. Ai është i dobët përballë saj, prandaj lutet që ajo mos e lëndojë atë, megjithëse e dëshiron kaq shumë.
- Përsëritja e pjesëzës *mos* **përforcon**, i jep **ritëm** strofës, thekson më tepër gjendjen shpirtërore të poetit.

**Përsëritja** dhe **mohimi** shkojnë bashkë, duke dhënë forcën dhe pushtetin e së bukurës, në përballjen me të cilën heroi ndjehet i dobët, pasi ai nuk e përballon dot, ai e nuk e pushton dot etj.

**2 pikë.** Kur jep një nga ndjesitë e përmendura më sipër dhe efektin përforcues.

**1 pikë.** Kur jep njërin nga përgjigjet, vetëm ndjesinë ose vetëm rolin e pjesëzës *mos*.

**0 pikë.** Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 9** **2 pikë****Model përgjigjeje:****a- Tipare që tregojnë mbështetjen e Naimit në poezinë popullore janë:**

- konceptimi i ndjenjës së dashurisë dhe mënyra se si e përjeton dashurinë.
- mënyra se si përdor elemente të natyrës në krijim.
- figuracioni; ( epitete, krahasime, simbole, metafora etj).
- gjuha e pasur, pasuria leksikore, shprehitë popullore (*P.sh leshratë në erë, do të qanj me thes në kokë...etj.*)
- elemente të metrikës.

**b- Tipare që tregojnë natyrën romantike të poetit janë:**

- kulti i ndjenjës.
- tema e dashurisë, dashuria si bipolare.
- nocionet estetike (vetë e bukura).
- lirizmi,
- etj.

**2 pikë.** Nëse përmend nga një tipar për secilën pikë (a,b).

**1 pikë.** Nëse jep vetëm një tipar.

**0 pikë.** Nëse jep tipare që nuk kanë lidhje me romantizmin ose me mbështetjen në krijimtarinë popullore /ose kur nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10****2 pikë****Model përgjigjeje:**

**a-** Vargjet **kumtojnë dëshirën dhe urimin e poetit**, që bukuroshja e tij të ketë rini dhe bukuri të përjetshme.

**b-** Folja është në **mënyrën dëshirore**

**2 pikë.** Nëse nxënësi jep kumtin e urimit dhe dëshirës dhe mënyrën e foljes.

Nxënësi do të marrë dy pikë edhe nëse të dyja përgjigjet përmbledhen brenda një fjalie: p.sh Poeti shpreh dëshirë, urim dhe folja është në dëshirore.

**1 pikë.** Nëse jep vetëm mënyrën dëshirore ose vetëm shpjegimin kuptimor të vargjeve.

**0 pikë.** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11****3 pikë****Model përgjigjeje:**

**a-** Vargjet, ku rimojnë dy emra janë:

p.sh; mos vështro si **pëllumbeshë**

mos u tund si **mbretëreshë**.

**Shënim:** këtu po japim emrat që rimojmë në krijim: **jeta/shigjeta, bukurinë/dashurinë/perëndinë, djalëria/pleqëria, shokë/kokë, gëzime/hidhërime.**

**b-** Vargjet, ku rimojnë dy folje janë:

p.sh; mos më vra, mos më **plagos**

mos më vdis e mos më **sos**.

**Shënim;** këtu po japim foljet, që rimojnë në krijim: **shkonte/shikonte, piku/iku, u venitë/u përtëritë.**

**c-** Efekti që krijojnë rimat e mësipërme është: **efekti tingullor, muzikaliteti.**

**3 pikë.** Nëse nxënësi jep dy llojet e shembujve të rimuar dhe muzikalitetin e poezisë.

**2 pikë.** Nëse jep vetëm dy shembujt ose një shembull + muzikalitetin.

**1 pikë.** Nëse jep një shembull rime ose vetëm muzikalitetin.

**0 pikë.** Për përgjigje të gabuar ose kur nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 12****4 pikë****Model përgjigjeje:****a- Raporti me djalërinë:**

Poeti kujton kohët dhe **moshën e rinisë**. E sheh të lidhur të bukurën dhe dashurinë me këtë kohë. Dashuria dhe e bukura atëherë shfaqen në formën e tyre më të plotë. I **sjellin gëzim**, ia **pasurojnë** dhe **ndriçojnë** jetën.

ose

**Bukurinë** dhe **dashurinë** me djalërinë e **lidhin gëzimi dhe hareja**.

**b- Raporti me pleqërinë:**

Poeti flet për pleqërinë duke e lidhur **me të tashmen artistike**. Në raport me heroin lirik, *bukuria* mbetet e re dhe *dashuria* për të nuk ka ndryshuar.

Nga ikja e djalërisë ai **vuan**. Humbja e dashurisë për të është vdekje.

**Bukurinë** dhe **dashurinë** me pleqërinë e **lidh vuajtja**.

**c- Detajet që realizojnë idenë e kohës pa kthim mund të përzgjidhen:**

- tani jetën ç'e dua,
- m'iku me vrap djalëria
- shtriga pleqëria
- ratë në det t'arratisë dhe **detaje të tjera brenda fragmentit**.

**3 pikë.** Nëse jep dy shpjegimet që lidhen me djalërinë dhe pleqërinë si edhe detajet.

**2 pikë.** Nëse jep vetëm dy shpjegimet ose një shpjegim dhe detajet.

**1 pikë.** Nëse jep vetëm detajin ose vetëm një shpjegim.

**0 pikë.** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 13****4 pikë****Model përgjigjeje:****13/a Shtjellimi i idesë. 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Përqendrimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.
- Përqendrimi te koncepti i së bukurës.
- Shtjellimi i idesë *bukuria si vlerë estetike* si pjesë e njeriut dhe e natyrës.
- Si e zbulon të bukurën? E bukura si zbulim.
- Përshkrimi i saj si nxitëse dhe ushqyese e ndjenjave njerëzore.
- Vlerësimi përtej saj, në cilësitë e tjera njerëzore.
- Vlerësimi dhe qëndrimi ndaj së bukurës kudo që haset etj.

**2 pikë.** Kur ka treguesit e mësipërm.

**1 pikë.** Kur trajton temën përkatëse, por nuk përdor përshkrimin si element.

**0 pikë.** Kur nuk përshkruan në lidhje me temën, kur nuk kuptohet asgjë, ose nuk shkruan fare.

**13/b Organizimi dhe struktura. 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Pjesët përbërëse (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Rend (rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
- Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
- Kalimet e kuptimshme (nga pjesa ose fragmenti në përshkrim) etj.
- Të jenë të renditura disa ndjesi, qëndrime, vlerësime etj.

**2 pikë.** Kur nxënësi i plotëson kriteret më lart..

**1 pikë.** Kur respekton vetëm strukturën formale, por nuk demonstroi cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin.

**0 pikë.** Kur struktura nuk na jep asnjë kuptim.

**13/c Stili dhe origjinaliteti. 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:**

- Shprehjet origjinale ( figuracioni, detaje, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
- Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues (me rrjedhshmëri, të ketë efekt, të ketë përshkrime, të ketë figura letrare, të ketë qëndrime artistike).
- Qartësia. Rendi i fjalëve dhe fjalive ( fjalët e renditura në fjali duhet të kenë kuptim dhe të përcjellin emocion, të përcjellin veçanti).
- Stili të jetë jo imitues, (mund të mbështetet te autori, por të ketë origjinalitetin e tij).

**2 pikë.** Kur ka treguesit e mësipërm.

**1 pikë.** Kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri.

**0 pikë.** Kur nuk thotë asgjë ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

**13/d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi)****2 pikë****Duhet të kihen parasysh:**

- Trajtat e duhura e fjalëve.
- Fjali të sakta.
- Shenjat e pikësimit.
- Shkronja e madhe.

**2 pikë.** Kur nxënësi ka bërë një përshkrim brenda normave të mësipërme.

**1 pikë.** Kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.

**0 pikë.** Kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

**PJESA II****SHEKSPIR****Makbeth (fragment)**

<b>Pyetja 14</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 15</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 16</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 17</b>	<b>D</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 18</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 19</b>	<b>B</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 20** **3 pikë****Model përgjigjeje:****a- Personazhet janë:**

- Banko
- Makbethi

**b- Tregon atmosferë dramatike: frike, ankthi, tensioni, pasigurie etj.**

**3 pikë.** Nëse nxënësi jep dy personazhet dhe atmosferën dramatike të frikës.

**2 pikë.** Nëse nxënësi jep vetëm dy personazhet ose një personazh dhe atmosferën dramatike.

**1 pikë.** Nëse nxënësi jep vetëm njërin personazh ose vetëm atmosferën dramatike

**0 pikë.** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 21** **4 pikë****Model përgjigjeje:****a- Mreti Duncan i dhuron Znj Makbeth:****a-1: diamant**

a-2: për të treguar **kënaqësinë** e tij nga pritja që iu bë, për **mikpritjen**, për ta **falenderuar** për darkën, për gostinë.

**b- GE është: gostin' e bukur.****c- Formimi: emër+mbiemër**

**4 pikë.** Nëse nxënësi gjen llojin e dhuratës, arsyen pse bëhet dhurata, grupin emëror dhe tregon si është formuar.

**3 pikë.** Nëse nxënësi jep njërin nga variantet e pikës (a), përgjigjen (b) dhe (c).

**2 pikë.** Nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet e vlerësimit më lart.

**1 pikë.** Nëse nxënësi jep vetëm njërin nga përgjigjet më lart.

**0 pikë.** Nëse nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22** **3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- Foljet janë: **qeshi dhe thirri**.

b- Ato janë në **marrëdhënie kundërshtie**

**ose**

- Krijonë **kontrast të fortë**, njëri qesh (vazhdon pafajësia e ëndrrës) dhe tjetri thërret, dëshmon **vrasjen, krimin**.

**ose**

- Tregojnë **veprimin** që ndodh shpejt (nga jeta te vdekja)

**3 pikë.** Kur nxënësi jep dy foljet dhe shpjegimin përkatës.

**2 pikë.** Kur nxënësi jep vetëm dy foljet ose një folje dhe shpjegimin.

**1 pikë.** Kur nxënësi jep vetëm një folje ose vetëm shpjegimin.

**0 pikë.** Kur nxënësi jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23** **1 pikë****Model përgjigjeje:**

-Makbethi i drejtohet diçkaje përfaqësuese, e cila për momentin përbën pikë referimi. Në gjendjen e tronditur psikike, ai do t'i drejtohet dheut themelfortë, të ngjeshur hekur, si zemra e tij ku s'ka më asgjë njerëzore.

- Përmes apostrofës i kërkon ndihmë dheut, domethënë tokës dhe jo qiellit, sepse vepra që po kryen nuk ka asgjë qiellore, hyjnore.

- simbolit të **tokës, dheut, besimit të tij, vullnetit të tij, natyrës** etj.

**1 pikë.** Nëse nxënësi thotë që Makbethi i drejtohet një force mbi të, sikundër në shembujt që kemi dhënë në përgjigje ose të ngjashme me to.

**0 pikë.** Nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24** **3 pikë****Model përgjigjeje:**

a- **Znj Makbeth i drejtohet Makbethit: Imzot!** Për t'i dhënë **kurajo**, për t'i kujtuar se **Zot i fronit** është ai, për t'i thënë se është **mbreti**, për t'i thënë që nuk i lejohej të zotit të shtëpisë **dobësia dhe dilema**, për t'i treguar shembullin e **gjakftohtësisë së vet, për etikë familjare** etj.

b- **Shekspiri e zbërthen anën psikologjike të Znj Makbeth përmes fjalëve dhe veprimeve të saj në fragment.** Në to ajo del: gjakftohtë, e qartë, sunduese, plot kurajë, e fortë, e vendosur, nuk ndalet para synimit që i ka vënë vetes, nuk e trondit krimi, etj.

Nxënësi, jo vetëm duhet të zbulojë disa tipare, por edhe të shpjegojë si realizohen ato në fragment.

**3 pikë.** Nëse nxënësi shpjegon përdorimin e veçantë të fjalës *Imzot* dhe jep psikologjinë e Znj. Makbeth, bashkë me shpjegimin përkatës.

**2 pikë.** Nëse nxënësi zbërthen vetëm anën psikologjike në mënyrë të plotë (konstatim dhe shpjegim). Nëse jep vetëm një aspekt të psikologjisë dhe përgjigjen e pikës (a).

**1 pikë.** Nëse i përgjigjet vetëm pikës (a), gjen një tipar të psikologjisë, por nuk e shpjegon atë.

**0 pikë.** Nëse jep përgjigje që nuk ka lidhje me ç’i kërkohet ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 25

**2 pikë**

### Model përgjigjeje:

**Veçori të kompozicionit të veprës Makbeth, që gjenden në këtë fragment janë:**

- ngjeshja e veprimit
- veprimi që rrjedh shpejt
- dialogu
- monologu
- detajet
- elementet skenikë
- gjuha e zgjedhur

Do të pranohen edhe elemente të kompozicionit, që gjenden në të gjithë veprën si: takimi me magjistricat, aluçinacionet.

- etj.

**2 pikë.** Nëse nxënësi jep dy nga tiparet më sipër.

**1 pikë.** Nëse nxënësi jep njërin nga tiparet më sipër.

**0 pikë.** Nëse përgjigja nuk ka lidhje me kompozicionin ose nxënësi nuk përgjigjet fare.